

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Burim Emërllahu, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit [REDACTED] [REDACTED] të cilën e përfaqson [REDACTED], kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaji, baza juridike borxh, me datë 22.01.2016, merr këtë:

AKTGJYKIM

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] Kosovës [REDACTED] me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet i padituri [REDACTED] nga Ferizaji, që në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të aktvendimit, të ia paguaj paditëses shumën prej 85.18 € ,si dhe shpenzimet nën kërcënimin e egzekutimit të dhunshëm ndalimi i mjeteve në para të cilat i padituri i ka në llogarin rrjedhëse dhe bartjen e shumës përkatëse në llogari të paditëses, marrjen, regjistrimin dhe shitjen e sendeve të lëvizshme dhe të palëvizshme të të paditurit dhe pagesa e kërkuar me para të paditëses

II. Detyrohet paditësja [REDACTED] në Prishtinë që kësaj Gjykate në emër të taksës gjyqësore për aktgjykim t'ia paguaj shumën e të hollave prej 15 euro.

A r s y e t i m

Paditësi [REDACTED] në Prishtinë ka kërkuar nga gjykata që të urdhërohet i padituri [REDACTED] nga Ferizaji, që në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të aktvendimit, të ia paguaj paditëses shumën prej 85.18 € ,nën kërcënimin e egzekutimit të dhunshëm ndalimi i mjeteve në para të cilat i padituri i ka në llogarin rrjedhëse dhe bartjen e shumës përkatëse në llogari të paditëses, me marrjen, regjistrimin dhe shitjen e sendeve të lëvizshme dhe të palëvizshme të të paditurit dhe pagesa e kërkuar me para të paditëses.

Kurse me datën 05.01.2016, përfaqësuesja e paditëses [REDACTED] e ka njoftuar gjykatën se heq dorë nga kërkesëpadia, kurse gjykata me aplikimin e nenit 149 ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata ka obliguar paditësen që kësaj gjykate t'ia paguaj në emer të taksës gjyqësore për aktgjykim shumën prej 15 Euro, duke u bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Më datë 22.01.2016

Gjyqtari
Burim Emërllahu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë në afat prej 7ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.

